

VENDIM
Nr.750, datë 9.11.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.198, DATË 5.4.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PRANIMET NË UNIVERSITETET DHE SHKOLLAT E LARTA, PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË, DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.198, datë 5.4.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

a) Fjala e dytë, e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Masa e tarifës së shkollimit, për studentët, që ndjekin studimet në degë të dytë, të përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave.”.

b) Pas pikës 10 të shtohen pikat 10.1 dhe 10.2, me këtë përmbajtje:

“10.1 Studentët, që ndjekin studimet, sipas fakulteteve dhe degëve përkatëse, me kuota dytësore, të përjashtohen, në të gjitha vitet e shkollimit, nga tarifa e veçantë e shkollimit.

10.2 Tarifa e shkollimit, e përcaktuar për kuotën e pranimi, për studentët, të cilët janë regjistruar me kuota dytësore, në fakultete dhe degë të ndryshme, të shkollave të larta, përpara vitit akademik 2006-2007, të reduktohet në masën e kuotës kryesore.”.

c) Pika 11 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11.Studenti i nënshtrohet vetëm në tarife shkollimi, e cila duhet të jetë tarifë shkollimi me kuota kryesore ose me degë të dytë. Studentët përsëritës i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, me kuota kryesore ose me degë të dytë, të vitit akademik 2006-2007.”.

ç) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet nga arsimit i lartë jopublik në arsimin e lartë publik, brenda sistemit tonë të arsimit të lartë (vite të ndërmjetme), si dhe ata nga jashtë Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen tarifës së shkollimit, të barabartë me tarifën e kuotave kryesore, duke filluar nga viti akademik 2006-2007.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga ndryshimi i tarifës së shkollimit, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha